



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

Nr. Serial000044

LEJE  
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR

Nr. 184 Prot., datë 25 / 03 / 2022

Miratuar me:

VENDIM TË KËSHILLIT BASENIT UJOR SHKUMBIN

Nr.4, datë 17.03.2022

Emri i individit/subjektit: "GERTI" SH.P.K

I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): J96829417K.

Baseni Ujor:SHKUMBIN

Qarku:ELBASAN

Bashkia/ Njësia administrative: LIBRAZHD,Nj.A LUNIK

Koordinatat e veprimtarisë: Vepra e marrjes 1: X= 526242.1; Y= 4579802.9; Z= 1170 m.m.n.d

Vepra e marrjes 2: X= 525196.9; Y= 4579986.8; Z= 1170 m.m.n.d.

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Hidroenergji, (HEC VARDARI)

Prurja mesatare  $Q_{mes}=0.6 \text{ m}^3/\text{s}$

Prurja ekologjike  $Q_{eko}=47,6 \text{ m}^3/\text{s}$

Sasia e ujit që jepet për përdorim:  $520 \text{ m}^3/\text{s}$

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka):  $0.52 \text{ m}^3/\text{s}$

Koordinatat ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer:

**Përroi i Zallit të Kostenjës**

Koordinatateshkarkimit të ujërave të përdorura

**Përroi i Zallit të Kostenjës**

Sipërfaqja e tokës, së cilësi shërben përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes):nuk ka

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): Të lejojë prurjen ekologjike si dhe nevojat e bujqësisë.

Periudha e vlefshmërisë: 16.10.2022

Hyrja në fuqi:Pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve

KRYETARI  
MAJLINDA PERRIU



### **Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujq sipërfaqësor.**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujq për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtete mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes;
10. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratine burimit ujq, gjatë ndërtimit dhe operimit të veprave;
11. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujq, me përjashtim të rasteve kur kjo është miratuar nga organet e administrimit të burimeve ujore;
12. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
13. Të lejojë rrjedhën ekologjike;
14. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujq, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
15. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujq në gjendjen e mëparshme;
16. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
17. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për përdorimin e burimit ujq nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
18. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore për veprimtarinë përkatëse.